

gosur rëndë në qafë. Po atë ditë, Mehmeti ka ndërruar jetë nga plaga. E kanë varrosur një ditë më vonë në Semetishte/Semetište. Shabani ka dhënë shpirt tri ditë më vonë. E kanë varrosur më 27.08.1998 në Pagarushë/Pagaruša [Malishevë/Mališevo]. Në datën 18.09.1999, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka.

Burimet: deklarata I.G, FDH-32535; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; *Serb Offensive against Suhareka Villages Escalates*, newsletter, KIC, 25.08.1998, FDH-29505; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e deshmorëve...*, FDH-36427.

Bexhet (Bajram) Gashi

(1.01.1943, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, punëtor i vreshtarisë, pesë fëmijë)

Ruzhdi (Bajram) Gashi

(5.09.1958, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, punëtor i vreshtarisë, katër fëmijë)

Në mëngjesin e datës **23.08.1998**, vëllezërit Bexheti dhe Ruzhdiu e kanë çuar me makinë djalin e Bexhetit dhe një mik të tij, që të dy ushtarë të UÇK-së, në pozicionet në afërsi të Studençanit/Studençane. Në kthim, u ndalën në Studençan/Studençane ta merrnin bashkëshorten e Ruzhdiut, Lumnijën, e cila gjendej te prindërit e vet.

Meqë në rrethinë dëgjoheshin grantimet, i kaluan dy orë duke pritur që situata të qetësohej dhe, më pas, u nisën për në qytet. Kur arritën te *Rruga e Reshtanit/Raštanski put* [Suharekë/Suva Reka], mbi automobilin u shkrepën dy plumba – një e ka qëlluar për vdekje Bexhetin në kokë, ndërkaq tjetri e ka plagosur rëndë Ruzhdiun. Makina e ka humbur kontrollin dhe ka dal nga rruga. Ka pasuar zjarr rafali mbi automobilin. Pas njëzet minutash, Ruzhdiu ka ndërruar jetë nga plagët vdekjeprurëse. Lumnija i ka kaluar 52 orë në makinë. Një grup policësh serb, me shirita në uniformë, e ka çuar Lumnijën në Shtëpinë e Shëndetit. Familjarët e Bexhetit dhe Ruzhdiut i kanë marr trupat e të vrarëve nga vetura. Policia u ka dhënë vetëm një orë afat për varrosjen e Bexhetit dhe Ruzhdiut. Ata u varrosën më 25.08.1998 në varrezat e Su-

harekës/Suva Reka.

Burimet: deklarata L.G, FDH-32534; deklarata A.H, FDH-10112; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; KKMRF, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 108, 912; *Serb Offensive against Suhareka Villages Escalates*, newsletter, KIC, 25.08.1998, FDH-29505.

Bahri (Hajrush) Gollopeni

(4.08.1977, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Bahriu me prindërit Hajrushin dhe Saniën, vëllain Shemsit dhe familjen e tij jetonin në afërsi të Stacionit të Policisë në Suharekë/Suva Reka. U inkuadrua në UÇK në fillim të muajit qershor të vitit 1998. Për detyrë e kishte sigurimin e pozicionit te vendi i quajtur *Pika e Lonit/Ljonijeva osmatračnica*. Gjatë betejës me forcat serbe më **23.08.1998** në **Reshtan/Raštane**, Bahriun e kanë qëlluar në kokë me pushkë snajperi duke e lënë të vdekur në vend. Bashkëluftëtarët e kanë varrosur një ditë më vonë në varrezat e fshatit Dobrodelan/Dobrodeljane. Mbetjet mortore të Bahriut janë rivarrosur më 18.09.1999 në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka.

Burimet: deklarata Sh.G, FDH-32536; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; *Serb Offensive against Suhareka Villages Escalates*, newsletter, KIC, 25.08.1998, FDH-29505; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e deshmorëve...*, FDH-36427.

Shefqet (Emin) Hoxha

(29.04.1958, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, punëtor në Ballkan Bellt, katër fëmijë)

Në bazë të urdhrin të policisë serbe, banorët e *Rrugës së Reshtanit/Raštanski put* [Suharekë/Suva Reka] e kanë braktisur mëhallën më **23.08.1998**, nga ora 20:00. Familja Hoxha nuk kishte njohuri për urdhrin e policisë serbe. Nga ora 21:30, në rrugë u dëgjuan disa të shtëna dhe anëtarët e familjes menjëherë e braktisën shtëpinë [Suharekë/Suva Reka]. U nisën drejt fshatit të Reshtanit/Raštane. Pasi i kaluan afro 500 metra, policët serb hapën zjarr